



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1804 Regj
Nr.3484 Prot

Tiranë, më 09.12.2021

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A
Adresa: Fier, Strum, fshati Strum, Rr. Nacionale Fier –Berat, km.18, godina nr.2/1 (Tel :0693575344)
Per dijeni: Shoqeria “Pik Industry” sh.p.k. NIPT L44324401A
Adresa: Autostrada Lushnje Fier Km 1 .



Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.62-2021-5386(1412), date 08.11.2021, i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Fier, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1804, Datë 22.11.2021 kërkesën e kreditorit Shoqeria “Pik Industry” sh.p.k. NIPT L44324401A ndaj debitorit Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fatura tatimore e shitjes Nr. 185, date 26.03.2021”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 3378 Prot, Datë 22.11.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr.62-2021-5386(1412), date 08.11.2021, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorëve Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore Shoqeria “Erjoni –Agro” sh.p.k. NIPT L62818403A, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdheri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ERIS SOTIRI

